

Në bazë të nenit 7 alineja 9 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15., 39/16, 164/18 dhe 190/19), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural njofton si në vijim:

THIRRJE PUBLIKE nr. 06/2022

për parashtrimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi për përkrahje financiare për zhvillimin rural për vitin 2022

I. LËNDË E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është ndarja e mbështetjes financiare për masat në vijim:

| KAPACITETET PRODHUESE TË KËRKUESIT | | |
|------------------------------------|---|---|
| Kodi i masës | Emri i masës | Vlera maksimale bashkëfinancuese të shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues |
| 121 | Investimet për modernizimin e ekonomive bujqësore | shpenzime të pranueshme deri në 4.500.000 denarë për shfrytëzues individual |
| 121.7 | Furnizime të pajisjeve për prodhimin e duhanit | |

II. SHFRYTËZUES

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim:

| Subjektet | Kodi i masës |
|---|--------------|
| Ekonomitë bujqësore të regjistruara në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, në përputhje me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. | Masa 121 |

III. SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE

Mjetet janë të destinuara për furnizim të pajisjeve për prodhimin e duhanit, të parashikuara nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2022.

Vlera maksimale e bashkëfinancimit të shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues për Masën 121.7 është 4.500.000,00 denarë. Mjetet ndahen për periudhën e realizimit në plan afarist dhe paguhen në nivel vjetor.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI PARASHTROHET

Kërkesat parashtrihen në mënyrë elektronike pas regjistrimit të realizuar në e-baranje.ipardpa.gov.mk

Një kërkesë mund të paraqesë vetëm një kërkesë për një masë ose maksimumi 2 kërkesa për masë të ndryshme duke marrë parasysh masat e tjera të Programit për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2022.

Kushtet të cilat duhet t'i përmbushin kërkesit e mjeteve janë përcaktuar me:

Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2022 ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 64/22, 81/22 dhe 88/22)

Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 88/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17, 83/18, 27/19, 152/19, 244/19, 275/19 dhe 110/21)

Rregulloren për kriteret e përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillimin rural ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17, 162/18, 100/19, 215/19, 24/20, 96/21, 276/21 dhe 91/22) dhe

Rregulloren për kushtet plotësuese më të përafërta për mbështetjen e masave për zhvillimin rural, shpenzimet e pranueshme dhe shuma e mbështetjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë individuale ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 72/14, 35/16, 59/16, 178/18, 77/19, 214/19, 276/21 dhe 91/22)

Kërkesit e mbështetjes financiare është e nevojshme të krijojnë kërkesë elektronike për mbështetjen financiare me të dhëna për lokacionin e investimit, të dhënat për investimin dhe në mënyrë elektronike të bashkëngjitin dokumentet e duhura të parapara për masën 121, nënmasën 121.7.

Kriteret të cilat duhet t'i përmbushin kërkesit janë si në vijim:

- Prodhuesit e duhanit me kapacitete të regjistruara prodhuese në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave

Madhësia e kapaciteteve prodhuese përcaktohet në përputhje me kapacitetet prodhuese të regjistruara në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Kërkesit që i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve për masën 121 radhiten me vlerësim të përcaktuar në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masat për zhvillimin rural ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124 /11, 80/13, 35/16, 101/17, 162/18, 100/19, 215/19, 24/20, 96/21, 276/21 dhe 91/22).

- **Kërkesat me numër të njëjtë të pikëve do të radhiten sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk**
- **Kërkesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para lidhjes së Marrëveshjes për ko-financim me Agjencinë**
- **Kërkesat të cilat nuk janë të parashtruara në mënyrë elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk nuk do të shqyrtohen.**

V. TËRHEQJE TË FORMULARËVE DHE UDHËZIME

Udhëzimi për regjistrim të kërkesve në sistemin për parashtrim elektronik të Kërkesës mund të merret në faqen fillestare në e-baranje.ipardpa.gov.mk. Udhëzimi për shfrytëzues për masë individuale mund të merret pas fillimit të krijimit të kërkesës për masën. Udhëzimi për shfrytëzues mund të tërhiqet në ueb faqen e



Agjencisë www.ipardpa.gov.mk ose të merret direkt në Agjencinë çdo ditë pune nga ora 8:30 deri 16:30 në adresën:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
bul. "3-ta Makedonska brigada" nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)
1000 Shkup**

VI. MËNYRA E PARASHTRIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesa e plotësuar elektronike për përkrahje financiare është e nevojshme të shkarkohet, printohet dhe nënshkruhet dhe së bashku me dokumentacionin e plotë shoqëruet të parashtrimit deri te Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural në zarf të mbyllur në të cilin në anën e përparme në këndin e lartë të majtë qëndron **Kërkesë për përkrahje financiare dhe Numri arkivues i Kërkesës (0622-12116-XXXX/1)**. Kërkesa mund të parashtrimit përmes postës së rekomanduar ose personalisht në sportelin e

Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arritje të vonuar ose të pakompletuar në sportel ose hapje të parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për parashtrim të kërkesave është 20.05.2022.

Informata më të hollësishme në kontakt tel: (02) 3097-460 ose në e-mail adresën:

ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe ueb-faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
Sektori për miratimin e projekteve**

Telefoni 02 3097-460, çdo ditë pune nga ora 08:30 deri në ora 16.00

E-mail:: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk